



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr \_\_\_\_prot

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**VENDIM  
Nr. 519, datë 24.09.2024**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL PËR  
GJYQTARET EMA SHAHOLLI DHE {...}, PJESË E PROGRAMIT TË  
VLERËSIMEVE PËR VITIN 2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61, pika 1, 63 dhe 86, shkronja “dh”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, bazuar në planifikimet 3-mujore të Programit të Vlerësimit 2024 të miratuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.18, datë 18.01.2024, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe pas shortit të realizuar,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren {...}, pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2024.
2. Caktimin e relatorit z. Ilir Rusi dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin znj. {...}
3. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2020-2022, për gjyqtaren {...}, pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2024.
4. Caktimin e relatorit znj. Gentiana Muçaj dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**